REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 26.12.2024 Prot.31 (tridhjetëenjë)

Protokoll nr. 31

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.11.2024.
4.P-V "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2025";
5.P-V "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminsitratës së Bashkisë Maliq dhe struktura të tjera për vitin 2025";
6.P-V "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025";
7.P-V"Për miratimin e listës të investimeve prioritare të Bashkisë Maliq për vitin 2025";
8.P-V "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 ";
9.P-V "Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028";
10. P-V "Për miratimin e bursave të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit profesional të vitit shkollor 2024-2025";
11.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin nëntor 2024";
12.P-V"Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.Estref Rusi banues në fshatin Sovjan Njësia Administrative Pirg, Stavro Cenolli në fshatin Vashtëmi Njësia Administrative Libonik, banesat e të cilve u dogjën si shkak i rënies të zjarrit";
13.P-V "Për miratimin e sistemit të pikëzmimit për programet e strehimit dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë";
14.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Rudina Bregu; Floreta Zaçe; Ronaldo Skënderi; Marainathi Avrami; Idlir Limllari; Klea Baçi;Pranvera Begolli; Gentiana Drabo; Eriseld Jonusllari; Petrit Kupe;

Aramando Dautllari; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Plator Çollaku; Ilia Xhuti;Eglantina Balli; Neresida Shindo; Marjeta Xhelollari; Albina Xhejo; Yllson Ibrahimllari; Lulëzim Hoxhaj; Server Xhuti; 24(njëzetëekatër) këshilltarë.

Mungesa: Xhuana Hoxhallari; Rovena Terolli; Enida Avdolli; Dalina Krekas;Almir Elezi; Andonaq Risto; Faslli Zholi; 7 (shtatë).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit:Almira Muka; Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Drejtore e Drejorisë e Planifikimit të Territorit:znj.Enkelejda Jonusllari; Drejtore e Drejorisë të Ardhurave:znj.Jona Grabocka; Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile; z.Stiljan Belishta; Përgjegjës i Zyrës të Strehimit;z.Ledion Mullalli;

Ornildi Demollari:Përshëndetje të gjithëve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, i nderuar Kryetari i bashkisë, të nderuar pjesmarës, fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë Maliq, mbledhjen e fund vitit një nga mbledhjet më të rëndësishme të Këshillit të Bashkisë, pasi në këtë mbledhje miratohet buxheti i vitit 2025, miratohet gjithashtu dhe Paketa Fiskale dhe disa dukumenta të tjera shumë të rëndësishëm.Para se të fillojmë më duhet të them dhe dy fjalë në lidhje me buxhetin, dua ti falenderoj të gjithë ata që kanë punuar për ta hartuar dhe dua të falenderoj dhe gjithë ata që do ta ndjekin vitin e ardhëshëm në zbatimin e tij dhe le të shprespjmë të jetë një buxhet të vijë sa më afër nevojave dhe kërkesave të qytetareve.Para se të fillojmë duhet të verifikojmë korumin, korumi realizohet sepse janë 22-23 Këshilltarë në sallë, kështu që mund të vijojmë.Me materialet e mbledhjes ju jeni njohur besoj kanë ardhur 5-6 ditë para, kështu ju ftoj të miratojmë rendin e ditës?

Kush është dakord ? 23 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 23 vota, Miratohet rendi i ditës prej 14 pikash, faleminderit!

Ornildi Demollari: Dua tju njoh dhe me vendimet e mbledhjes së kaluar janë gjithësej 10 vendime,3 tre janë me karkter (normativ) dhe 7 (shtatë) me individual ose kolektiv.

Ju ftoj të kalojmë në votim proceverablin e mbledhjes së kaluar.

Kush është dakord ? 23 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 23 vota, Miratohet proceverabali, faleminderit! Dua tju kujtoj dhe konfliktin e interesit, nëse dikush nga ne ka konflikt interesi me pikat e rendit të ditës, nuk duhet të përfshihet në diskutime dhe në votim për atë pikë.Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës, P-V "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet për shkeljet

apo kundravajtjet administrative për vitin 2025"; Kemi diçka këtu, e do dikush fjalën? Komisioni?

Petrit Kupe: Si rregull para miratimit të buxhetit miratohen paraprakisht Taksat dhe Tarifat për vitin pasardhës, ajo që ne pamë si Komisim, konstatuam se nuk ka ndryshime thelbësore për asnjë Taksë dhe Tarifë, për vitin 2025, kështu që ne e miratuam në Komision, atje është një numur i konsiderueshëm me Taksat dhe Tarifat të cilat ekzisitojnë për shkak të procedurave dhe bazës ligjore, pothuaj se një pjesë e madhe e tyre nuk aplikohen nuk janë të përshtatshme, por ato që aplikohen ngelen ato që ishin në vitin 2024.Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër te Taksat? Kryetar!

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mirëdita të gjitheve! Në fakt ashtu si e tha dhe Kryetar i Këshillit është mbledhja më e rëndësishme e vitit, jo vetëm për buxhetin por dhe për Paketën Fiskale, dua ti bëj me dije anëtarët e Këshillit por dhe qytetarve se jemi në të njëjat nivle me vitin 2024, me disa ndryshime të vogla të cilat edhe Komisioni ja bëmë të ditur dhe ju po ashtu edhe pse e keni në material, ndryshimi i Paketës Fiskale 2024 me atë 2025, kemi të Tarifave ajore dhe linjave nëntokësore të sistemeve Kabllore, nga 200.000 lekë në 150.000 lekë dhe 50.000 kemi kaluar në 100.000 lekë në vit, janë hequr nga përjashtimet për vitin 2025 kategoritë e mëposhtme:

Tarifohen për mirëmbajtje të varrezave publike dhe fshatrat e NJ.A, shërbimin e mirëmbajtjes të varrezave duhet ta bëjmë në gjithë bashkinë, ndoshta jo me punonjës të përhershëm, por me Shërbimin tonë Publik, për pastrim, rrethim etj.Po të marrim në konsideratë ato zona ku i kishin përjashtuar kemi investuar më shumë në lidhje me rrethimet e tyre dhe shërbime të tjera, atëherë kjo tarifë minimale edhe nga auditit i KLSH është parë e arsyeshme që duhet të vendoset si shërbim ndaj komunitetit, nuk përjashtohen për gjobë me vonesë pagesat që nuk paguhen në afat, nuk përjashtohen familje që klasifikohen emigrantë do trajtohen për nivelin e Tarifave që janë, nuk përjashtohen nga Tarifa e pastrimit, gjelbërmit, familjet që kanë lejë në bashkinë e Maliqit por që jetojnë jashtë territorit të saj, pasi kjo në momente të caktuara le shkak për abuzim.Pika 3 shtesë në Tarifën në ndikim mjedisor është shtuar një vlerë 50.000 lekë.Nga drejoria e Planifikimi të Territorit janë hequr tetë Tarifa, kërkesë për plan vendosje objekti energji elektrike, kontroll për ngritje kantier ndërtimi përfshi dhe murin rrethues, kontroll për piketim të strukturës, kontroll për përfundim të themleve të kuotës zero, kotroll për ngrije karabina, kontroll për përfundimin e fasadave, kontroll për përfundimin e sistemit të jashtëm dhe njxerje dokumenti nga sistemi i lejave, të gjitha këto bëhen zero, nga ana tjetër drejoria e Planifikimi të Territorit ka shtuar shtatë Tarifa, Aplikim njoftim raporti i Mbikëqyrësit (e-leje), Kërkesë për ndërhyrje me njoftim/punime që nuk kërkojnë të pajisen me leje ndërtimi në zonat rurale, Kërkesë për riparim dhe çarjet pjesore në muret rrethuese, Kërkesë për shtrimin e oborreve me shtresë të hollë betoni, Kërkesë për riparimin dhe zëvendësimin e ulluqeve dhe oxhaqeve, Kërkesë për vendosjen e tendave të diellit, Kërkesë për punimet civile për rrjetet ose sistemet e komunikimeve

elektronike/telekomunikacioni (sipas pikës 1.4, neni 6, VKM 408,datë 13.05.2015). Përjashtimet nga Paketa e vitit 2025, ju propozojmë të përjashtohen:

Përjashtimet nga Paketa Fiskale 2025

- Për bizneset e reja, të cilat administrohen nga gratë kryefamiljare, tarifat vendore reduktohen në masën 30% për vitin e pare të ushtrimit të aktivitetit.
- Për bizneset e reja, të hapur rishtazi, të cilat admnistrohen nga të rrinj të moshës 18-25 vjeç, përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore për vitin 2025. (*Për subjekte të reja , me objekt të ndryshëm nga aktiviteti familjar primar.*)
- Familjet që trajtohen në ndihmë ekonomike apo qe perbehen vetëm nga "*pensionistë të vetmuar*" do të paguajnë vetëm 70 % të tarifave.
  - Në kategorinë "*pensionistë të vetmuar*" përfshihen të gjithë pensionistët e vetëm, pa përkrahje, që jetojnë në kushte të vështira ekonmike. Lista me të dhënat për këta persona do të sigurohet nga Sektori i Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Maliq.
- Gratë kryefamiljare që nuk janë në marrëdhënie pune përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore.
- Të përjashtohen nga tarifa e gjelbërimi familjet e fshatrave:
  - Në Njësinë Administrative Gorë të gjitha fshtarat.
  - Në Njësinë Administrative Moglicë të gjitha fshtarat.
  - Në Njësinë Administrative Libonik, fshatrat Zboq, Beras, Shkozë, Kembëthekër, Mëmël dhe Manastirec.
  - Njësinë Administrative Pirg fshatrat Bubuq dhe Qershizë.
- Të përjashtohen nga tarifa e pastrimit të gjithë banorët e fshatrave:
  - Në Njësinë Administrative Gorë të gjithë banorët e fshatrave përveç : Zvarisht, Lozhan i ri dhe Lozhan.
  - Në Njësinë Administrative Libonik, banorët e fshatrave Zboq, Beras, Shkozë, Kembëthekër, Mëmël dhe Manastirec.
  - Në Njësinë Administrative Maliq, banorët e fshatrave: Bickë, Goçë, Plovisht dhe Gjyras.
  - Në Njësinë Administrative Pirg, banorët e fshatrave: Bubuq dhe Qershizë.
  - Në Njësinë Administrative Moglicë të gjithë banorët e fshatrave përveç fshatit Moglicë.
- Të përjashtohen nga tarifa e ndriçimit:
  - Në Njësinë Administrative Maliq, banorët e fshatrave: Bickë, Goçë, Plovisht dhe Gjyras.
  - Në Njësinë Adminstrative Libonik, banorët e fshatrave: Shkozë, Këmbëthekër, Beras, Zboq, Memël dhe Manastirec.

- Në Njësinë Adminstrative Gorë, banorët e fshtarave : Shalës, Selcë, Marjan, Dolanec, Mjaltas, Babjen.
- Në Njësinë Admnistrative Moglicë përveç Moglicës, Zerecit dhe Popçisht të gjithe fshatrat e tjerë përjashtohen nga tarifa e ndriçimit.
- Në Njësinë Administrative Pirg banorët e fshatit Bubuq dhe Qershizë.

- Të përjashtohen nga tarifa e mirëmbajtjes së kanaleve kullues:
  - Në Njësinë Administrative Maliq, banorët e fshatrave: Bickë, Goçë, Plovisht dhe Gjyras.
  - Në Njësinë Adminstrative Libonik, banorët e fshatrave: Shkozë, Këmbëthekër, Beras, Zboq, Memël dhe Manastirec.
  - Në Njësinë Administrative Pirg banorët e fshatit Bubuq dhe Qershizë.
  - Të gjithë banorët e Njësive Administrative Gorë dhe Moglicë.

<u>Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:</u>

pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;

- pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- banesat sociale në pronësi të bashkive;
- pasuritë e paluajtshme - ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- strukturat akomoduese " *Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special* ", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht " *brand name* ";
- ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/ pension social/ kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

- Përjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore, tokat bujqësore që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për **<u>5 vitet</u>** e para nga çasti i mbjelljes.Këto janë disa nga përjashtimet apo ndryshimet që ne kemi propzouar në Paktën Fiskale dhe në totalin e përgjithshëm Pakta Fiskale kap një vlerë prej 300 milon lekë aq sa e kemi patur dhe një vit

më parë me një diferencë të vogël në vlerë monetare.Kaq ishte shpjegimi që mund tju jap, nëse ka pyetje, jam i gatshëm tju dëgjoj, e kemi diskutuar në Komision, këto ndryshime mund tja vemë në dispozicion gjithë Këshlltarve për ti njohur dhe për tja u prezantuar qytetarve me të cilët komunikojnë çdo ditë.Faleminderit!

Ornildi Demollari: z.Kryetar faleminderit! Kemi diçka tjetër ? Kemi diçka nga grupi i opozitës? E kalojmë në votim pikën 4?

Kush është dakord ? 23 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 23 vota, Miratohet pika 4, faleminderit!Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminsitratës së Bashkisë Maliq dhe struktura të tjera për vitin 2025"; Po Petrit në emër të Komisionit.
Petrit Kupe: Struktura e vitit 2025, pothuaj se është e ngjashme me atë që kemi miratuar disa muaj më parë, numri total i punonjësve nuk ndryshon, do përmendim disa nga ndryshimet që ka kjo strukturë, mbasi e diskutuam dhe para 3 muaj, ka pak ndryshim në strukurë në pakësimin e Agjencisë Mbështetëse, të një pjese që ka të bëjë me Sektorin e Enve nën Presion kalon në vartësi të administrates qëndrore, ky është një nga ndryshimet dhe ndryshimi tjetër i rëndësishëm është ai që u premtua në mbledhjen e më parshme, rritja e pages për pjesën tjetër të punonjësve të cilët nuk përfituan nga rritja e pages që pësoi gjithë administrate e parshikuar nga ana e Kryetarit me një rritje prej 5000 lekë, çdo punonjës që ka patur paga minimal 40.000 ka patur një rrijte page prej 10-12% nga paga ekzituese, për mendimin tone ky është një hap i rëndësishëm, mbasi nuk e thellon diferencën e pages midis administratës dhe punonjsëve të thjeshtë por përsëri ngelet një diferencë e thekesuar sepese rrtija në administratë ishte e konsiderueshme 35-40% por kjo ka dhe mekanzima të tjera, me VKM mund të ndryshojë dhe paga minimale mund të rritet si çdo vit por dhe vetë bashkia ka mundësi të rrishikojë më tutje këtë pjesë .Këto ishin dy nga ndryshimet thelbësore të structures të cilën ne e shqyrtuam dhe nuk kishim çfarë të shqyrtonim më sepese e pamë më hollësisht para tre muajsh dhe jemi dakord të miratohet kjo strukturë për vitin 2025.Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër ? Po Luli.

Lulëzim Hoxhaj:Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, ne që në fillim ne shprehemi votën kundra për këtë pikë.

Ornildi Demollari: Si grup pse nuk flet Egla?

Lulëzim Hoxhaj:Më kanë ngarkaur mua.Për se jemi kundra? Mednojmë që një administratë me kaq numur punonjësish, për një bashki si bashkia e Maliqit me 630 punonjës është një barrë shumë e rëndë për këtë buxhet që ne po miratojmë sot.Mendoj që ka shumë vend dhe nuk po hyj në detaje, si në strukturë ashtu dhe në numrin e punonjësve, por ka shumë vend që kjo të jetë më

fleksibël, të jetë më efektive në shërbim të komunitetit.Po ti futemi zërave ka vende shumë, po them disa gjëra të vogla, në buxhetin e këtij viti, janë rreth 2.7 milon lekë që do miratohen për pastrimin, ata që ndjekin njerzit që do punojnë është po ky fond, po them diçka tjetër, nuk e di ekzaktësisht por besoj që i kalon rreth 20-30 vetë rroje pyjesh dhe zjarresh, jam plotësisht dakord se është vërete një fenomen që duhet të adminstrohet.Kam një pyetje? Nga këto rojet e pyjeve, sa procevrable ka për njerës që dëmtojnë pyllin? Ose për zjarret apo fenomene të tjera? Këta 30 vetë që janë të anagzhuar në këtë pozicion që janë, ka shumë mundësira që këta mund të zvëndësohen, mund të zvëndësohen me metoda dhe forma të tjera, pyllin nuk e rruan rrojtari por e rruan komunitetit, sepse ky pyll i shërben komunitetit, ne duhet të investojmë në fushën e ndërgjegjësimit të njerëzve që janë në këtë territor për ta rruajtur pyllin e tyre, kështu që mednoj që ka shumë vende për ta pare dhe në administratë, mndoj që ka rezereva të mëdha dhe nëse e krehim administrate, shohim që këtu është burimi për ti kthyer në investime dhe në fusha të tjera.Ne para mbledhjes sa përfunduam dhe mbledhjen e Komisionit të Arsimit, Kulturës, Rinisë, të gjithë themi se kemi shumë për të bërë në këtë fushë, i drejtohem dhe Këshilltareve të krahut tjetër, unë them këti lekë të shkojnë në fushë tjetër.Do i kthehem pak dhe rrojeve të zjarrit, për këto raste ka edhe aplikacione, është future teknologjia sepspe ky është roli i Adminsitratorit të shkurtojë numrin e punonjësve për të rritur efiçensën dhe kursehen para, ka aplikacione që shumë efektivë dhe janë falas, njëri nga këta aplikacione mund tja u ve dhe unë në dipozicion nëse doni, nuk dua të hy në detaje, por vetëm te Pylli i Fazanve nuk e di sa vetë janë të angazhuar? Pyetjen e shtroj të drejtpërdrejtë? Cili është efektiviteti i këtyre punonjësve që punojnë atje?

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër? Po Kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në fakt Luli foli në emër të grupit edhe përmblodhi disa aspekte të Administratës me llogjikën që ai beson, por unë shikoj që në çdo rast edhe në këtë rast që flasim, jo vetëm në Administratë por në të gjithë punën tonë ka vend për të parë, për të përmirësuar punën, normalisht duhet të flasim me fakte, me argumente për të që ne prezantojmë edhe për të treguar që struktura e Administratës të bashkisë nuk është 630 ashut si thotë Luli, por është 200 apo 165, nga kjo strukurë vetëm Arsimi, Edukatore Kopshti, Pastruese të shkollave të mbulura nga Ministria janë 110 dhe kjo nuk është Administratë bashkie, pasi ne kemi 57 shkolla do të thotë që minimalisht 57 Sanitare të cilat pastrojnë, ndezin zjarrin për tu ngrohur nxënsit dhe po të shtojmë këtu 57 e dhe 110 bëjnë 170 vetë pjesa e Arsimit të cilën ne e mbulojmë, po të shtojmë këtu dhe Kaldaistë dhe rojet e shkollave, ky numur i domozoshëm ndërthuret për të shkuar këtu.Përmende pak më parë dhe është bërë objket bisede Pylli i Fazanve, nuk e kuptoj çfarë keni me një pikë e cila tashmë e vizitueshme, jo vetëm nga vendas por dhe të huaj, ku janë 4 roje që punojnë ditë e natë që ai Pyll mos prishet, spepse është dëmtuar para 15 vitesh edhe shumë mirë që e morri bashki, që e mirëmban dhe tani nuk prihet më atje, ka Fazanë, Kaprollë është bërë një pikë e vizitueshme në bashkinë tonë, që nuk e kemi kaq shumë, ashtu si kanë bashkitë e tjera dhe mundohemi ti vemë në shërbim të komunitetit, turisteve edhe për tu

përfaqësuar në fund.Nga ana tjetër ne kemi, një fushë nga më të mëdhatë pas asaj të Myzeqesë , ku shteti na jep fonde të drejtpërdrejta për pastrimin e kanalve kulluese, vaditës, nuk përmbytet më fusha e Maliqit, koleg Luli, të flas për zantin që kemi të dy, janë 900 km kanale kullues dhe vaditës, që po pastrohen për herë të dytë, me ata Mekanizatorë me ata punëtorë, a ka vend për përmirësim? Patjetër që ka kudo, pa përjashtim dhe unë kam ankesat time, ankesat e qytetrave për mënyrën si punohet, sa efiçentë janë etj.Por nuk mund ta themi këtë me një të rënë të laspit, nuk mund të jetë kjo.Kemi një sistem Rugë Rurale nga më të vështirat në zonë malore, që edhe ata i paguajmë me 4, 6, 7 orë në vartësi të gjatësisë të rrugës, në vartësi të performancës që ata kanë etj, por zona e Gorës dhe Moglicës por jo vetëm ata por dhe zonat tona malore dhe kjo ka vetëm 20 punëtorë, Shërbimi Zjarrëfikës një nga më të mirët në Shqipëri ka 16 punonjës, nga të cilët 14 i paguan buxheti i shtetit me fondet e saj, janë djem të rinj që na kanë përfaqësuar denjësisht, jo vetëm në Maliq e Korçë por edhe në Greqi dhe vende të tjera ku ka patur zjarre. Nga ana tjetër Pyje-Kullota, patjetër kemi sipërfaqen pyjore më të madhe jo vetëm në Korçë por në të gjithë Shqipërinë, a ka atje probleme? Patjetër që ka, por ata 7-8 veta që ne paguajmë Teknikë Pyjesh, apo ata 4-5 Roje zjarri që janë në të gjithë Territorin e bashkisë që kanë rreth 24 mijë ha pyje, si mos i lemë? Ti kërkojmë llogari është diçka tjetër, ata duhet të jenë të parët ta evidentojnë zjarrin, të njoftojnë të gjithë gruoet vullnetare, kemi sektor Mekanik, sektor Kulture që në totalin e përgjithshëm e kemi diskutuar dhe pak muaj më parë bashkia qendër, është ajo që tha Petriti që të gjithë pjesën e Tatim paguesve, por kjo mund të jetë momentale pasi qeveria do bëjë ndryshime ligjore, që të gjithë Tatim paguesit, që mbledhim Taksa në teren ti kalojnë me agjent tatimor në Ujësjellës ose OSHE, deri sa kjo të ndodhë ne jemi të detyruar ta mbajmë.Kemi Policinë Bashkiake me një numur të kufizuar me atë që na takon në bazë të popullsisë, pasi për 1000-1500 banorë duhet të ketë një Polic ne kemi vetëm 12, këtu hyn dhe Gjendja Civile, e cili është një shërbim i deleguar tek ne me 7 punonjës, në totalin përgjithshëm bashkia qendër 202 punonjës, nga të cilët Administrata ka 165 dhe pjsa tjetër janë, Polici Bashkiake, Mbrojte nga Zjarri, Sektor Mbështetës, kemi Arisim Para-shkollor 110 punonjës, Gjendja Civile me 7 dhe kemi Agjencinë e Shërbimeve Mbështetëse me 311 punonjës, nga të cilët ashtu si e përmenda pak më lart, futet Sektori i Shërbimeve, Ujitje-Kullim, Pyje-Kullota, Rrugë Rurale, Mekanika etj.Nuk kemi bërë ndonjë ndryshim të madh për efekt të pagave pasi e kemi bërë në Shtator, ajo çka ne kemi prezantuar, ka të bëjë me një rritje page prej 5000 lekë për çdo punonjë shërbimesh me një nivel 10-12% në vartësi të peshës që ata kapin dhe me pagat e para dhe disa rregullime që Komisioni propozoj për njësimin e disa pagave të Drejtoreve në Administratë dhe disa punonjës të financës, të cilët në Agjencinë apo dhe në NJ.A të cilët duhet të kenë një përmirësim, këto u diskutuan dhe u mendua të kihet në konsidertatë, kaq sihte ajo që diskutuam për Administratën.Ajo çka unë bie dakord me Lulëzimin, është që ne duhet të kërkojmë më shumë llogari, më shumë që ata, atë pagë që marrin ta justifikojnë me më shumë punë, për programe që kemi dhe mund të na i vini në dispozicion ne jemi të gatshëm në çdo rast, që mund të na përmirësojë shërbimin.

Ornildi Demollari: Faleminderit Kryetar! Kemi diçka tjetër këtu te struktura? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 16 vota pro.
Kundra? 7 z.Yllson Ibrahimllari, z.Lulëzim Hoxhaj, z.Server Xhuti, znj.Neresida Shindo, znj.Eglantina Balli, znj.Marjeta Xhellollari, znj.Albina Xhejo.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 16 vota, Faleminderit! Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025"; Kush e do fjalën, Komisioni i Financës.

Mbledhjes i bashkohet dhe Këshllitri z.Plator Çollaku, shkon në 24 numri i Këshllitarve në sallë.

Petrit Kupe: Edhe ky P-V u pa nga Komisioni, unë mendoj që ky Projket-Buxhet është nja nga më të mëdhenjtë që nga viti 2015 deri tani, jo vetëm në krahësim me vitet e para por dhe në krahësim me vitin 2024, transferta e pakushtëzuar 423 milon lekë në vitin 2024 parshokhet në 472 milon lekë në vitin 2025, pra 49 milon lekë më tepër, gjithashtu dhe transferta sektoriale nga 186 milon lekë, në 223 milon lekë, ose 37.7 milon lekë më shumë nga viti 2024 dhe buxheti në total nga 910 milon lekë për vitin 2024, parashikohet në 996 milon lekë në vitin 2025, ose 86 milon lekë më tepër, kjo rritje flet mire për një rritje të performances të buxhetit të cilin transferon qeveria pranë buxhetit të bashkisë, sepse pjesa tjetër e buxhetit parshikohet të realizohet me të ardhurat e veta, pot ë shohim vitin 2024 të ardhurat nuk janë realizuar këtë vit më shumë se 50%, pra përgjithësisht kemi të bëjmë me një buxhet pozitiv, me një buxhet që shpreh më shumë shërbime në komunitet, me një buxhet që shpreh më shumë investime në komunitet, ne jemi plotësisht dakord për miratimin e këtij buxheti, porn ë këtë buxhet mendojmë se ka dhe sfida të tjera, për të cilat bashkia do të angazhohet për të realizuar 100% buxhetin e parshikuar, kjo është njëra sfidë sin ë shpenzime operative dhe në investime, sfidën tjetër që e ka të vazhueshme bashkia, ka rritjen e të ardhurave, e cila pavarsisht që nuk realizohet në masën e parshikuar, po në dinamikë duhet të rritet më shumë se në vitin 2024, vemë re që dhe një sfidë të rëndësishme ka bashkia realizimin e investimeve, investimet e reja parashikohen në vlerën 95 milon lekë, parashikohen më pak se vitin e kaluar, por janë parshikuar në rritje të ndjeshme invesimet e parashikuara në vitin 2024, do të sygjeronim për thithjen e më shumë investimeve nga buxhetit i shtetit, apo FSHZH, apo nga donatorët, spepse kërkesat për invesitime janë vazhdimisht në rritje.Këto ishin disa nga konkluzionet që aritëm ne si Komision, për të tjerat mund të flasin dhe Këshilltarët e tjerë, patjetër dhe Kryetari i Bashkisë, por nuk kemi arsye pse mos miratojmë një buxhet kaq pozitiv.Faliminderit.

Mbledhjes i bashkohet dhe Këshllitri z.Plator Çollaku, shkon në 24 numri i Këshllitarve në sallë.

Ornildi Demollari: Faleminderit!Kemi diçka tjetër? Kolegët e opozitës?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dua të nënvizoj që, fal dhe një çelje fondi që qeveria ka bërë pak ditë më parë dhe Këshilli e ka miratuar në një mbledhje online, ju kërkoj ndjesë për

shpejtësinë e veprimit por ishim të detyruar për ta bërë dhe ai fond do shtojë me 19 milon lekë plus investimet për vitin 2025, shkojmë në një nivel më të lartë nga viti 2024, marr shkas nga ajo që tha Petriti ka ulje të investimeve, në fakt do të ketë rritje.Për të hyrë në temë dua të shpjegoj që transferta e pakushtëzuar në 2025 ka një rritje me 11.65%, shifrat i keni në material shpjegimet i kemi dhënë por do përmend disa momente, kemi një rritje pothuaj të të gjithë transfertave, këto transferta të vitit 2025 kapin një vlerë të përgjithëshme prej 669 milon lekë, po të shtojmë dhe 300 milon lekë nga buxheti i pavaruar që ka qëndruar në të njëjtin nivel, totali i përgjithëshëm shkon rreth 996 milon lekë, një rritje gati 9.5% nga një vit më parë.Paketën fiskale ja u shpjegova pak më parë, nga detjimi që ne i kemi bërë buxhetit për zërat kryesorë për të patur një buxhet të balancuar të ardhurat me shpenzimet pa difiçit do të thotë që ndarja që i është bërë buxhetit për efekt të pagave apo sigurimeve shoqërore edhe të shpenzimeve operative, pagat kapin një vlerë 49%, investimet kapin 30%, shpenzimet operative kapin 17%, po të shtojmë këtu dhe ndryshimet që ka pësuar buxheti për efekt të vendimmarjeve të fundit, ka një ndryshim të rritjes të peshës të investimeve të vitit 2025 të reja, po të shtojmë këtu dhe investimet në proces vlera është e konsiderueshme, na takon ne të kemi një mirë menaxhim të fondeve për të realizuar sa më shumë investime dhe shërbime ndaj komunitetit, besoj që administrata e bashkisë këtë e ka bërë më së miri dhe gjatë vitit 2024.Kemi bërë një ndarje të buxhetit për të dy strukturat, ashtu si e kemi miratuar në muajin Shtator, kemi buxhet të mirtuar për bashkinë qendër dhe një buxhet për Agjencinë Mbështetëse, sipas sektorve që ajo përfshin dhe detajimin patjetër ja u kemi hedhur në pasqyrat përkatëse, po të marrim një pasqyrë përmbledhjese, këtu kemi parshikuar dhe dy investime në nivel 3-vjeçar, që është sistemim asfaltime rrugë viti 2025, në vlerën 95 milon lekë dhe ndërtim korsi biçikletash, trotuare, kryqësimi Libonik-Pylli i Fazanve, i cili është një investim që sapo e kemi fituar me FSHZH, FSHZH do na verë në dispozicion gjithë pjesën materiale, unë sapo kan nënshkruar akt-marrveshjen me një vlerë rreth 50 milon lekë të reja dhe ne do të kryejmë puntorinë për efekt të të gjithë kësaj, do të bëhet një investim shumë i rëndësishëm, jo vetëm për banorët e asaj zone, të cilët eleminojnë aksidentet, por do jetë dhe një aks shumë i rëndëishëm për Pyllin e Fazanve që është një atraksion turistik.Pjesa tjetër është investime rrugësh në gjithë territorin e bashkisë për të cilën, ne kemi hartuar projket preventivat, në dy faza, për të bërë të mundur ndërhyrjen në ato rrugë që janë problematike në territorin e bashkisë, ashtu si e thashë dhe pak më parë, kemi dhe zëra të tjerë, të cilat janë transferta të ndryshme për Drejtorinë e Tatimeve, Këshillin e Qarkut Korçë, fond rezervë të cilat kapin vlerën përkatse, në këtë pikë kemi një transfertë për Klubin e Futbollit të Maliqit, ka njër rritje prej 10.800 lekë, apo 108 milon lekë, kemi një transfertë për Kombinatin e Sheqerit 5.2 milon lekë, këtu kërkoj të kalojmë në likujdim të kësaj ndërrmaje që mos kemi më shpenzime ekstra në vitet e tjera dhe do kërkoj nga Këshilli i Bashkisë në rolin e Asamblesë të Përgjithëshme të marrë një vendim, ndoshta që sot për efekt të mbylljes të punës për Këshillat Mbikqyrës të Kombinatit të Sheqerit, nëse do shpërblehen të shpërblehen vetëm për ditën e mbledhjes, për një apo dy mbledhje për efket të likujditetit që ne duam ta kalojmë këtë ndërmarrje, sipas eksperve dhe bazës ligjore në fuqi.Fond Social kemi parshikaur 1 milon lekë, fond për Emergjencat Civile 4

milon lekë, kemi parshikaur një fond prej 500.000 lekë për nxënsit ekeslentë, për të cilën kërkoj mbështetjen e Zyrës Arsimore për të na vënë në dispozicion listën përkatëse të atyre që e përfitojnë që ne ta zbatojmë sa më parë, kemi dhe një fond rezevrë 2 milon lekë, që Këshilli i bashkisë, si për fodnin e Emergjencave Civile, por dhe për fondin rezervë ka të drejtë ta përdorë gjatë vitit buxhetor sipas kërkesave që ne ju sjellim.Në lidhje me investimet kemi parshikuar një fond 1 milon lekë projekte, për ndërtime, konstruksione 19.460 mijë lekë , rrugë 52.118 mijë lekë, ujësjellsa 7.7 milon lekë, pajisje të ndryshme 1890 lekë, inventar ekonomik 7.5 milon lekë dhe keni një dtejim shumë hollësishëm dhe për shpenzimet e karburanitit për çdo mjet që ka bashkia, detyrime për shoqërinë e mbetjeve KRMW, Shoqata e Autonomisë Vendore, shpenzime për spërmarjen e pastrimit.Për herë të parë futim një fond për Akademinë e Pushtetit Vendor, që do jetë një fond rreth 477 miljë lekë, është hera e parë që do e përdorim për efekt të trajnimit të administratës të bashkisë në rrang vendi, kështu që dhe ne i jemi bashkangjitur kësaj Akademie, në konceptin tonë është shumë i rëndësishëm.Shpenzime për Këshilltarët e Bashkisë dhe Kryetarë fshati, jemi në të njëjtin nivel në masën 10% të pagës të Kryetarit të Bashkisë apo Administratorve respektivë, përjashtuar vetëm Kryetarët e fshatrave të bashkisë qendër, të cilët e kanë 6%, që këta Kryetarë fshati të zonës malore, mos marrin më shumë se ata të zonës fushore që kanë popullsi më të madhe.Në buxhetin e 2025 kemi bërë një detjim të fondeve që mbulojnë Këshillin, pati një kërkesë në Komision për efekt të shpenzimeve për trajnim apo për eksperiencë që Këshilli bashkisë merr nga 200.000 lekë për tu rritur nuk patëm ndonjë kundërshtim, do e rishikojmë me drejtorinë e financës pa ta rritur diçka.Mbrojtja Civile ashtu si përmenda është rreth 4 milon lekë, presim një fond nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ta çelë gjatë muajit Janar për ta përfshirë në fondin e Mbrojtjes Civile, i cili mund të përdoret jo vetëm për rrënie zjarri por edhe për reabilitim ndërtesash të cilat mund të jenë risk, në buxhet për efekt të buxhetimit me pjesmarje kemi për përfshirë edhe pjesë të barzisë gjinore, kemi bërë disa shpjegime për sa i përket strukturës, zërave buxhetorë, reabiltim të objekteve shkollore apo dhe objekte të tjera të cilat kanë impakt në këtë pikës, si mund të jetë një Ujësjllës, atë çka kemi parshikuar është reabilitimin e rrjetit të brendshëm të Moglicës, i cili është bërë prej shumë kohësh dhe ka nevojë për reabilitim.Në të njëjtëohë keni dhe detjimin për Agjencinë e Shërbimeve Mbështetëse, ajo çfarë kemi parë është që nuk kemi kaluar shumë zëra te kjo Agjenci edhe për efekt të një mungese përvoje si diçka e filluar rishtas, kemi futur zërat kryesorë për tu menaxhuar prej tyre, kap një fond prej 266 milon lekë, të cilat do i kalojnë kësaj Agjencie për ti menaxhuar vetë, Shërbimi Publik ka një fond prej 6.9 milon lekë, Mekanika 11.8 milon lekë, Ujitje-Kullim 16 milon lekë, Rrugët Rurale 5.2 milon lekë, Kultura 4 milon lekë si shpenzime operative dhe në totalin e përgjithshëm kapin një vlerë prej 44.3 milon lekë, po këtu kemi parshikaur dhe shpenzime operative për karburant për mjetet që ata posedojnë.Në buxhetin e vitit 2025 do kemi dhe investime në proces nga buxheti i vitit 2024, i cili ka patur vlerën 128 milon lekë por kjo do ulet pasi materiali ishte shpërndarë, do të ulet me një vlerë 19.304.866 mijë lekë, të cilat i bashkangjiten fondit të investimeve për vitin 2025, fonde të reja për të cilën ne ju kemi propozuar edhe një ndryshim të cilin do e shtojmë në investime në nivel programi, nga të

cilat 15 milon lekë do përdorim për sistemim asfaltim rrugë në qytetin e Maliqit, rreth 2 milon lekë bashkëfinacim projketesh, diferenca do kalojë për reabilitim banesa të cilat mund të kenë probleme me çatitë apo me rrezik shembje në të gjithë territorin e bashkisë.Shumë faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar! Yllson kishe diçka?

Yllson Ibrahimllari:Përshëndetje të gjithve!Në emër të grupit të opozitës, ti bëj pyetjet një nga një?Materialin që na keni paraqitur, duam pak sqarime, unë besoj se kjo bashki i ka kapacitet që materialet e buxhetit të na vijnë me parë se 5 ditë, pavarsisht kur janë dërguar edhe një pjesë e tyre, flas për sa i përket bursave të arsimit të mesëm etj, nëse të tjerat e kanë plotësuar afatin 5 ditor sipas ligjit, kemi një debat këtu për të diskutuar, rregullorja thotë jo më pak se 7 ditë pune kalendarike, kue vjen puna për buxhetin 10 ditë pune.Ligji e thotë jo më pak se 5 ditë, nëse dikujt ja çojmë rrogën 500 mijë lekë, nuk besoj se shkelim ligjin kur e ka 240 mijë lekë.Ironinë kujdes e kam thënë disa herë, kam ardhur të diskutij buxhetin e komunitetit dhe d dhe diçka tjetër, ashtu si kërkojmë në çdo mbledhje konfliktin e intersit, dua që për çdo pikë të rendit të ditës, të ketë një shprehje të Komisionit të Ligjeve, Mandateve dhe Rregulloreve, ju duhet të thoni, që ky rend dite që na paraqitet është konform legjilacionit apo jo.Kalojmë e buxheti, i nderuar kryetar buxheti dhe PBA 2025-2027që parqesni.A është në të njëjtën linjë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe strategjinë e miratuar? Planin e Përgjithshëm Vendor, ka kaluar në datën 14.10.2020 dhe është shpallur në datën 16 Tetor 2020.A janë objektivat e këtij buxheti, objekte të miratuara në Planin e Përgjithshëm Vendor? Te pika 3 e objektivave, ju thoni ofrimi sa më shumë shërbimeve, çdo me thënë? Kemi më pak investime në këtë projket-buxhet nga një vit më parë, të propozuara në vitin 2024 kemi 128 milon lekë, për vitin 2025 keni 92 milon lekë.4 Paga dhe sigurime shoqërore janë 2.5 herë më shumë se investime, si do përmirësojmë shërbimet në nivel bashkiak? Kur kemi këtë disporpocion.5 Shpenzimet operative janë 14%, ku brenda janë dhe pagat për punonjësit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo nuk janë pagat, ndjesë.

Yllson Ibrahimllari: Dakord.Si do i përmirësosh? Ashtu si thoni te objektivat.6.Shpenzimet operative për arsimin janë 10 herë më pak se shepenzimet për Shërbimin Zjarrëfikës, për të cilët vlen të kenë gjithë përgëzimet tona, por në fakt ne japim çdo muaj fonde për zjarre të rëna në bashkinë e Maliqit.7 Fondi që ne japim për Këshillin e Qarkut është i barabartë me fondin për arsimin 9-vjeçar në Maliq.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund ta shpjegoj pak, fondet e arsimit nuk i kemi parashikuar në këtë buxhet, pasi do ja u sjellim në buxhetin shtesë bashkë me detajimet, pasi nuk kemi dashur ta rëndojmë këtë buxhe, i kemi konsolidaur dhe do ju sjellim në buxhetin shtesë.

Yllson Ibrahimllari: Dakord.8 Tek invesimet nuk asnjë zë të rëndësishëm për kanale Vaditëse dhe Kulluese, si shpjegohet që invesimet në vitin 2025 janë 91 milon e 784 mijë? Kurse dy vitet

e tjera 2026, 2027 te buxheti afat mesëm janë 950 milon, pra vimë çdo vit me ulje.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit!Kemi diçka tjetër? Apo tja japim fjalën Kryetarit?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Fondet janë për shërbime të ndryshme, që mund të jenë nga shpenzime opertative deri në investime, por kjo do të bëhet prezent në buxhetin shtesë, ne lidhje me dokumentacionin që duhet të hyjë në Këshill 10 ditë para, unë do ju sygjeroja që ju duhet ta ndryshoni rregulloren e funksionimit të Këshillit dhe të bazoheni te ligji dhe ligji prashikon 5 ditë, jam shumë dakord me atë të bursave, nuk e di pse ka ndodhur, mund të jetë një moment që të plotësohen sa më shumë aplikantë të përfitimit të bursave pasi dokumentacioni bëhet me vonesë, por nuk besoj se mund të jetë një problematikë dhe për Këshillin dhe për ne që të arrijmë limitin e fundit që sa më shumë fëmijë të aplikojnë, se për deri sa na ka ardhur një numur i konsiderueshëm, mos djegim kuotat, do ju sygjeroja që ta lemë të hapur këtë moment që Sekretari i Këshillit, Drejtoria përaktëse të shtojnë sa më shumë nxënës që ta përfitojnë makismalisht këtë bursë që ju takon.Unë do ju sygjeroja Kryetar, Këshilltarë që rregullorja të ndryshojë, pasi ne punojmë çdo ditë, mund ta bëjmë dhe me dy javë, por do ndodhemi në një situatë që do bllokohemi kur ne duhet tju prezantojmë një P-V, i cili del dhe për 5 ditë dhe ligji e parshikon dhe ne pse duhet ta spostojmë këtë moment.Dua të shpjegoj që Planin e Përgjithshëm Vendor, është një dokument shumë i rëndësishëm, i cili ka pikat kryesore të zhvillimit të zonës tonë, por jo vetëm të bashkisë tonë, por në nivel dhe rajoni, ajo nuk është se përmban projkete të veçanta të themi, por ka zëra që ndryshojnë nga njëri vit te tjetri, por të jesh i bindur Doktor, ne jemi munduar ta përafrojmë sa më shumë me Planin e Përgjithshëm Vendor edhe pse vete ai kërkon të rishikohet dhe të përmirësohet për zëra të caktuar, por patjetër Drejtoria e Planifikimit të Territorit, merr në shumë raste jo vetëm me buxhetin tonë, por dhe me donatorë dhe Institucione të tjera kombëtare, pika të Planit të Përgjithshëm Vendor për të qenë sa më afër tij.Patjetër që objektivat e këtij projketi, janë pjesë apo futen në pjesë të veçanta të Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar nga KKRTSH.Kemi më pak investime në vitin 2025! Kemi më shumë investime në vitin 2025, ajo që citova pak më parë, po të marrim në konsidertatë nga 98 milon lekë, po të shtojmë dhe 19 milon të tjera, shkojnë rreth 130 milon dhe kalojmë vlerën e investimeve për vitin 2024, po të shtojmë dhe projketet në proces, unë mund tja u jap me shifër të saktë që midis dy viteve kemi nivel më të lartë investimesh dhe për vitin që di vijë.Pagat dhe sigurimet shoqërore, patjetër që kap një vlerë të konsiderueshme, pasi flasim për rrteh 630 punonjës dhe këtu nuk hyjnë vetëm fondet tona, është një pjesë e konsiderueshme e fondeve sektoriale, të cilat janë fonde të buxhetit të shtetit që nga Sektori i Uitje-Kullim, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri, Pyje-Kullota, Rrugët Rurale, janë fonde sektoriale, nuk janë të transertës tonë, pavarsisht se ne i futim në një zë, Gjendja Civile edhe pse ju sjellim një buxhet total, në të ardhura dhe shpenzime për të përgjithshmen, po të bëjmë një ndarje të fondeve, sa merr peshë Administrata dhe sa investimet, përjashtuar shpenzimet sektoriale, kjo vlerë patjetër është shumë më e ulët.Shpenzimet operative kapin vlerën 17% dhe ne nuk mund të blejmë materiale më

shumë kur kemi gjendje në magazinë po marr një zë, ndaj edhe të gjithë Drejtoritë përaktëse, bëjnë një situatë të të gjithë shpenzimeve do të realizojnë gjatë vitit 2025, ka një grup pune, një komision ligjor, i cili evidenton të gjitha nevojat, situatën që kanë magazinat tona dhe pastaj bëjnë vetëm blerje që mund të jenë defiçitare.Por unë mendoj që kjo ndërmarje bën shumë volum pune, po të marrim në konsideratë që ne nuk bëjmë me procedura prokurimi, as për lyerje shkollash, as për riparime, por i kryejmë të gjitha me punonjësit tanë, për të kursyer edhe vlera, por edhe për të përfituar edhe vlerën e TVSH e cila është një ngaresë shumë e madhe në punët tona.Shpezimet operative të arsimit, e shpjegova pak më lart do të jenë në mbledhjen e buxhetit shtesë, nuk e kemi parshikuar këtu, ose kemi parshikuar diçka të vogël dhe patjetër ato do kenë peshën e tyre shumë të madhe, për të mbuluar gjithë shpenzimet për ngrohje, energji elektrike, për reabilitime të ndryshme, për kënde lojrash etj.Fondet për kanelet kulluese, është e njëjta situatë, kemi parashikuar fonde në këtë buxhet, por do sjellim dhe në buxhetin shtesë, fondet e kursyera nga një vit më parë dhe patjetër do jemi në një nivel më të lartë se në vitin 2024.Investimet në PBA, nuk lidhen pasi ato vijnë vit pas viti, ne nuk mund të parashikojmë investime në vitin 2027, pa ditur si do jetë trendi i rritjes, pasi janë disa piketa, të cilat jepen nga Ministria e Financave sipas VKM-së, për Tvanet Buxhetore.Në lidhje me fondet për investime kapitale për Ujitje-Kullim, është një ja situatë, ato janë fonde që çelen nga Ministria e Bujëqsisë, Emergjencat Civile, në vartësi të programeve, apo projekteve që ne aplikojmë dhe shpallemi fitues.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar! Kemi diçka tjetër? Po.

Pranvera Begolli: Aktualisht, Yllsoni përmendi që Komisioni i Ligjeve, duhet të jetë gjithmonë i pranishëm, por unë si Kryetare Komisioni duke parë që janë Komisionet përkatëse që të ndjekin procedurat dhe duke parë që baza ligjore nuk ka patur probleme, natyrisht që nuk e kemi mbledhur Komisionin e Ligjeve, në atë pikë të rendit të ditës, kur do ketë problematika në lidhje me bazën ligjore, natyrisht do mblidhet Komisionin i Ligjeve. Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit Pranvera! Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 17 vota pro.
Kundra? 7 z.Yllson Ibrahimllari, z.Lulëzim Hoxhaj, z.Server Xhuti, znj.Neresida Shindo, znj.Eglantina Balli, znj.Marjeta Xhellollari, znj.Albina Xhejo.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 17 vota, Kemi 17 vota pro, 7 kundra asnjë abstenim. Buxheti miratohet Faleminderit! Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës, P-V"Për miratimin e listës të investimeve prioritare të Bashkisë Maliq për vitin 2025"; Kush e do fjalën? Komisioni?
Petrit Kupe: Jemi dakord të miratohet.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kemi bërë një projekt me investime kryesore, të ndara sipas, kulturë, rrugë, sipas programve buxhetore, por jemi të hapur për këdo që ka një ide konkrete ta shtojmë si projket, se nuk janë financime akoma, por është një projket që kërkon një

vendimmarrje, që momente të caktuara institucione të ndryshme si FSHZH kërkojnë apo Minsitirtë përaktese dhe një nga piketat është a ka vendim Këshilli, që ka projketet prioritare dhe kjo na jep avantazhe kur ne aplikojmë për një projekt, jemi të hapur të shtojmë çdo lloj proj keti.

Yllson Ibrahimllari: Ka kërkuar Komisioni i Arsimit një projket për Qendrën Komunitare ditore për fëmijët me aftësi ndryshe, jam i gatshëm me gjithë njohjet që kam, dua të kontriboj me sa kam mundësi, projketin mund ta përagtisë znj.Drabo bashkë me Komisionin, mund të negocjojmë dhe me Ambasadën Franceze për këtë projket.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 18 vota pro.
Kundra? 7 z.Yllson Ibrahimllari, z.Server Xhuti, znj.Neresida Shindo, znj.Eglantina Balli, znj.Marjeta Xhellollari, znj.Albina Xhejo.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 18 vota, Kemi 18 vota pro, 6 kundra asnjë abstenim. Miratohet Faleminderit! Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 ";

Petrit Kupe: Ashtu si i mirtuam para pak kohësh, këto i bashkangjiten buxhetit, për të pare dinamikën e kërkesave, është një procedure ligjore, jemi dakord.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kryetar do shtosh diçka?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kjo është një procedurë standarte, Ministria e Financave, ligji për buxhetet vendore, kërkon që ne të miratojmë Programin Buxhetor afat mesëm për 3 vitet e ardhshme buxhetore, bazuar dhe në tavanet, ne kemi pasqyruar dhe vlerat përkatëse për vitet 20225, 2026, 2027 për shpenzimet edhe të ndarë sipas programve buxhetore, bashkë me të kemi prezantuar dhe kalendarin përaktës si detyrim ligjor, i cili është një kalendar shumë strikit për të ndjekur afatet, i cili drejtohet nga Kryetari i Njësisë vendore.Ne sjellim këtë material në Këshill, e çojmë në Ministri pasi ju e keni miratuar, na vijnë vëretjet apo miratimi përaktës, e kalojmë përsëri në Këshill, është një procedurë standarte, e cila në çdo rast Këshilli e ka kaluar, me plotësimet e duhura apo me vëretjet që Ministria e Financave ka sjellë.Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kolegët e opozitës për pikën 8? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 17 vota pro.
Kundra? 7 z.Yllson Ibrahimllari, z.Lulëzim Hoxhaj, z.Server Xhuti, znj.Neresida Shindo, znj.Eglantina Balli, znj.Marjeta Xhellollari, znj.Albina Xhejo.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 17 vota, 7 kundra. Kalojmë te pika 9 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028"; Kemi diçka këtu, Kryetar?
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ashtu si e thashë dhe më parë, kemi një kalendar të përcaktuar, me hapat që do ndiqen nga Janari deri në Dhjetor me hapat që duhet të ndiqen për të

miratuar një Projekt Buxhet afatmesëm, i cili i paraqitet Këshilli dy herë, i çohet Ministrisë të Financave, ajo bën vëretjet bazuar në tavanet buxhetor, të mirtaura me VKM, të cilat janë strikte dhe nuk të lejonë as ti shtosh as ti pakësoh, është një përllofaritje e thjeshtë nga ana financiare, të cilën ja u prezantojmë dhe e ndjekim hap pas hapi duke marrë kërkesa buxhetore me dëgjesa publike dhe duke i prezantuar te ky material.

Ornildi Demollari: Faleminderit! E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 17 vota pro.
Kundra? 7 z.Yllson Ibrahimllari, z.Lulëzim Hoxhaj, z.Server Xhuti, znj.Neresida Shindo, znj.Eglantina Balli, znj.Marjeta Xhellollari, znj.Albina Xhejo.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 17 vota, 7 kundra. Kalojmë te pika 10 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e bursave të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit profesional të vitit shkollor 2024-2025";
Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Për sa i përket planit për ndarjen e bursave për arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe arsimit profesional të vitit shkollor 2024-2025, përktësisht Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Ekonomisë kanë dërguar pranë bashkisë Maliq, numrin e kuotave të përfituesve për burse. Për arsimin e mesëm të përgjithshëm ishin 46 kuota, ndërsa për arsimin e mesëm profesional kemi 90 kuota.Kërkoj ndjesë për vonesën e dorzimit të materialit pranë Këshillit, por edhe në momentin e fundit kemi patur nxënës që dorzonin dokumenta për arsimin e mesëm profesional, gjithashtu kemi patur edhe 5 aplikatë të tjerë gjatë diteve që janë nadrë materialet e Këshillit, që duan të bashkangjiten këtij P-Vpër të përfituar burse, për arsimin e mesëm professional, duke qenë se ne atje kemi paraqitur 63 aplikantë, ndërkohë që kemi 90 kuota.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Arsimi i mesëm i përgjithshëm është plotësuar? Ka kërksa që nuk janë plotësuar?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Po, arsimi i mesëm i përgjithshëm është plotësuar.Jo nuk ka deri tani.

Gentiana Drabo: Unë jam me mendimin e Kryetarit, këtë pike ta lemë të hapur për të bërë të mundur të përfitojnë sa më shumë nxënës, duke qenë se kemi kuota sipas kritereve të përcaktuara.

Neresida Shindo: Kam një paqartësi, bursat për gjimnazet e përgjithshme, jepen për gjimnazet e Maliqit, apo të Korçës? Sipas ligjit nëse ka gjimnaz të përgjithshme në NJ.A, nuk lejohet që një nxënës të kalojë nga Maliqi në Korçë në gjimnaz, e kam ekspereincë personale.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Me sa do kjo është liberalozuar pak, nuk e di sa e vërtetë është.

Neresida Shindo: Sipas ligjit nëse ka gjimnaz të përgjithshme në NJ.A, nuk lejohet që një nxënës të kalojë nga Maliqi në Korçë në gjimnaz, vetëm nëse mere shtëpi me qira në Korçë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jam në një mendje me ty, që nxënist tanë, duhet të jenë në shkollat tona, mos ketë shkurtim mësuesish, por si është ky moment ligjor nuk di ta them, por përderi sa ka kërkesa, kemi bursa nuk mund ti djegim dot.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Sipas VKM-së 666 "Për përcaktimin e kuotave dhe nivelit të përfituesve me bursë", është e përcaktuar që një nga kriteret, duhet të ketë vendbanimin 5 km nga shkolla, kemi kritere eknomike, jo eknomike, VKM-ja i ka të përcaktura shumë qartë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Brenda bashkisë përfiton dikush bursë?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Kemi patur vitin e kaluar një rast, nga Sheqerasi në Pojan, i cili plotësonte kriterin mbi 5 km.

Gentiana Drabo: Ka një sistem të mire përcaktuar me një sere dokumentash, të cilat i ngrakon në sistem, me ato dokumenta mund ta rregjistrojë fëmijën në një shkollë të mesme dhe ashtu si thatë dhe ju nëse ka një kontratë qiraje për banim në një territor tjetër, e ka të drejtën, e pranon sistemi, pastaj na takon ne që fëmijët tanë ti çojmë në shkollat që kemi, pasi pjesa dërmuese e shkollave që kemi, kanë infrastrukture mire, staf të mire mësimor.

Neresida Shindo: Ne nuk duhet ti nxitim nxënsit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne jemi për të kundërtën a ka mundësi ti krijojmë kushte sa më të mira, me ngrohje qëndrore, palestër etj, të themi që jemi të konkurueshëm dhe jemi njëlloj si shkollat e Korçës, po kjo nuk do të thotë që prindi edhe pse unë personalisht jam kundra, do ishte që ata të studiojnë në shkollat tona.

Ersiseld Jonusllari: Po shikoj arsimin e mesëm të përgjithshëm, këta janë të gjithë nxëns në Korçë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po sepse duhet të plotësojë kriterin 5 km, nga Vashtëmia mund ta përfitojë bursën në Maliq?

Idlir Limllari: Do isha i mendimit të përfitojnë bursë vetëm nxënsit e arsimi profesional.

Yllson Ibrahimllari: Pavarsisht opinionit, kemi dy pricipe për të ndarë, pjesa morale është ajo që diskutojmë ne, Kryetari, anëtarët e këshillit.Moralisht ne mund të ndikojmë te kjo, Maliqi ka nivel arsimor të mirë, nxënës që shkojnë në dhe në Universitete të nivele të larta dhe kjo është krenari për këtë Krahinë asrim dashëse.Problemi është që ne kemi një dosje aplikimi që nuk mund ta ndalojmë dot, ata fëmijë e përfitojnë këtë, çfarë mekanizma social ne mundet, të shkojmë të nxitim që ata të jenë më të vetë dijshëm dhe të jenë këtu.Sigurisht ajo që thotë

Inxh.Idliri, por duhet propozim për hap ligjor, që të ndalohet për të gjitha ato nivele arsimi që bashkia Maliq, apo nivel rajonal që nuk i plotëson, Gjeologji Miniera, Agronomi i Mesme prsh, këta të shkojnë të përfitojnë bursë.Ne mund të marrim vetëm ndonjë iniciativë sygjeruese, nuk besoj se kemi fuqi mbi përcaktimin e dosjeve të aplikimit.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 24 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 24 vota, miratohet faleminderit. Kalojmë të dy arsimet.

Kush është dakord ? 24 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 24 vota, miratohet faleminderit. Kalojmë te pika 11 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin nëntor 2024"; Kemi diçka këtu?

Yllson Ibrahimllari: Kur do e ketë mundësinë ky Këshill, ta shohë bashkinë Maliq, pa ndihma enonomike?

Ornildi Demollari: Ermanda ke diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 24 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 24 vota, miratohet faleminderit. Kalojmë te pika 12 e rendit të ditës, P-V"Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.Estref Rusi banues në fshatin Sovjan Njësia Administrative Pirg, Stavro Cenolli në fshatin Vashtëmi Njësia Administrative Libonik, banesat e të cilve u dogjën si shkak i rënies të zjarrit";Kemi diçka këtu?
Neresida Shindo: Pse ka kaq shumë raste rënie zjarri në bashkinë tone? Dhe cilat janë shkaqet?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nga informacioni që ne kemi, shumica e zjarreve janë nga shkarkesa elektrike, për efekt të amortizimit të të rrjeteve, apo rrejte të cilat janë bërë shumë vite para, rrejte që shërbenin për ndriçim dhe për diçka të vogël, jo për të mbajtur pajisje për ngrohje, ky është shkaku në shumicën e rasteve, amortizimi bën të mundur rënien e zjarrit, për fat të mirë nuk kemi patur raste të humbjes të jetës, por shpetësia e veprimit ka qenë në kohë.Zjarrëfikist nuk mund të eleminojnë rënien e zjarrit, por të mos lenë përhapjen e zjarrit në godina të tjera afër.

Ornildi Demollari: Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Lulëzim Hoxhaj: Kam unë diçka, është e vërtetë kjo që në çdo mbledhje të diskutohet për zjarret, duhet ti orejntojmë njerzit të shkojnë të sigurojnë banesat e tyre, banesat të cilat janë me hipotekë.

Ornildi Demollari: E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 24 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 24 vota, miratohet faleminderit.Miratohen të dy rastet e rënies të zjarrit me 24 vota pro. Kalojmë te pika 13 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e sistemit të pikëzmimit për programet e strehimit dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë";
Yllson Ibrahimllari: Kemi një raport nga Komisioni për pikën 13? Është z.Kryetar këtu.

Idlir Limllari: Po është mbledhur Komisioni dhe është bërë raporti i pikëzimit, duhet të jetë pasqyruar.Janë pikëzimet që do mblidhen për familjet dhe në bazë të tyre dali fituesit.Jemi dakord, e kemi parë një muaj para.

Yllson Ibrahimllari: Dhe ne dakord jemi.

Ornildi Demollari: Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 23 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 23 vota, miratohet faleminderit.Pika e fundit diskutime të tjera.

Neresida Shindo: Kam një shqetësim lidhur me stadiumin e Maliqit, fëmijët e Akademisë të Skënderbeut i bëjnë në Maliq ndeshjet, investimi që është bërë atje le shumë për të dëshiruar, bari është i rëshqitëshëm, gropa të mbushura me ujë pas shiut.Më vjen keq që gjithë ai investim të ikë dëm.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Do e marr të mirëqenë shqetësimin tuaj dhe do e verfikoj, por varet se çfarë kushte kërkojnë ekipet që luajnë atje.Mund të them që ajo si fushë pas rënies të shiut krijon disa pellgje, por pastrohet sepse ka drenazhim.Por do e verifikoj në vend.Ajo fushë kërkon të mbushet pas shiut nga punonjësit me rërë gome, ne e kemi gjendje, ndodh që pas ndeshjes rëra lëviz nga një vend në tjetrin dhe krijojnë gropa, ndaj duhet krehur çdo ditë dhe duhet të mirëmbahet.Ke shumë të drejtë dhe të falenderoj për shqetësimin.

Yllson Ibrahimllari:Në kuadër të kësaj, nuk e di si jeni me procedurat e linçensimit, por unë kam folur dhe me Gertin, po ja u them dhe ju prarpraskisht, nëse ekipi i futbollit të Maliqit, kjo dhe për efekt të zbutjes të shpenzimeve në FSHF, qoftë kjo dhe për një defribilator që ja u kërkojnë, qoftë dhe për liçensën e një mjeku, mëqense jam profesionist, jam i gatshëm të vihem në dispozicion vetëm për efekt të federimit, jo të ndjekjes të ekipit në ndeshje, jam i gatshëm të vij pa pagesë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Sekretari i Këshillit ta ndjekë këtë.

Yllson Ibrahimllari: Te diskutime të tjera, të mblidhemi dhe të diskutojmë Komisionet që nuk janë funksionalë, në Janr të bëjmë një formatim të Komisioneve të Këshillit, nuk kemi pse ti mbajmë, nuk mund të jem unë Kryetar i Komisionit të Arsimit, duke qenë Genta këtu.Mund ti merrni ju të gjitha Komisionet, por vetëm mblidhini.

Pranvera Begolli: Ka të drejtë.

Yllson Ibrahimllari:Për rregulloren që ke miratuar këtë mendim ke patur?

Ornildi Demollari: Ja kam thënë dhe koleges në Kyesi, ligji prevalon mbi rregulloren.Nëse do duhet ajde të bëjmë ndryshime te rregullorja.

Yllson Ibrahimllari: Kaloje në konsultim publik rregulloren, duhet të kesh kujdes të lexosh më shumë rregulloren.

Ornildi Demollari: Jam shumë i kujdeshëm dhe me shumë respket po ju kthej përgjigje.Kemi diçka tjetër?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Do doja një mirëkuptim të Këshillit, për një vendimmarje për punën e Këshillit Mbikqyrës të Kombinatit vetëm kur kanë mbledhje.

Ornildi Demollari:Këtu mbyllet mbledhja e Këshillit, vazhdojnë diskutimet në cilësinë e Asamblesë së Përgjithëshme të Kombinatit.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI